



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 9, datë 17. 07. 2009

**PËR “DISA NDRYSHIME NË VKB NR.49, DATË 19.12.2008 PËR  
“DISA NDRYSHIME NË NIVELIN E PAGAVE NË BASHKINË E  
TIRANËS”**

Në mbështetje të nenit 32, gërma “ç” të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); të nenit 6, gërma “a” dhe “b” të ligjit nr.8487, datë 13.05.1999 për “Kompetencat për caktimin e pagave të punës” (i ndryshuar); të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”; VKM-së nr.1619, datë 02.07.2008 për “Klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page, dhe për caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore” (i ndryshuar) dhe VKB-së nr.49, datë 19.12.2008 për “Disa ndryshime në nivelin e pagave në Bashkinë e Tiranës”, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I:**

1. Niveli i pagave i përcaktuar në pikat 1, 2, 3 të VKB-në nr.49, datë 19.12.2008 për “Disa ndryshime në nivelin e pagave në Bashkinë e Tiranës” do të ndryshohet sipas lidhjeve nr.1, nr.2 dhe nr.3 bashkëngjitur vendimit.
2. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë më 1 maj të vitit 2009 dhe do të përballohen nga fondet e planifikuara për rritjen e pagave në buxhetin të këtij viti.
3. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Drejtoria e Financë-Administratës.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

Sokol DERVISHAJ

**K R Y E T A R**

**Lidhja nr.1 – Niveli i pagës për nëpunësit civilë në Bashkinë e Tiranës**

<b>EMËRTIMI</b>	<b>Klasa</b>	<b>Grupi</b>	<b>Paga e grupit</b>	<b>Vjetërsia</b>	<b>Shtesa për pozicion</b>
Kryetar i Bashkise	—	—	—	—	170 000
Zv/Kryetar i Bashkise	—	—	—	—	134 000
Administrator i Përgjithshëm	<b>I</b>	<b>b</b>	12 000	2%	115 000
Drejtor i Kabinetit	<b>II</b>	<b>a</b>	12 000	2%	105 000
Sekretar i Këshillit Bashkiak	<b>II</b>	<b>a</b>	12 000	2%	105 000
Drejtor i Përgjithshëm	<b>II</b>	<b>a</b>	12 000	2%	105 000
Këshilltar në Kabinet	<b>II</b>	<b>b</b>	12 000	2%	88 000
Drejtor Drejtorie	<b>II</b>	<b>b</b>	12 000	2%	88 000
Përgjegjës Sektori	<b>III</b>	<b>a</b>	12 000	2%	69 000
Përgjegjës Zyre	<b>III</b>	<b>b</b>	12 000	2%	52 000
Specialist I	<b>III</b>	<b>b</b>	12 000	2%	52 000
Specialist II	<b>IV</b>	<b>a</b>	12 000	2%	41 000
Specialist III	<b>IV</b>	<b>b</b>	12 000	2%	31 000
Sekretar i kryetarit	<b>IV</b>	<b>a</b>	12 000	2%	41 000
Specialist me arsim te mesëm	—	—	—	—	30 000
Sekretare	—	—	—	—	30 000

**Lidhja nr. 2 – Niveli i pagës për punonjësit me kontratë**

<b>Nr</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>Paga</b>
1	Shofer	30 000
2	Pastrues	30 000
3	Roje	30 000
4	Centralist	30 000
5	Korrier, postier	30 000
6	Furnitor	30 000
7	Kartelist	30 000
8	Mekanik	30 000
9	Mirëmbajtës	30 000
10	Receptionist	30 000
11	Operator	30 000
12	Të tjerë	30 000

**Lidhja nr. 3 – Niveli i pagës për punonjësit e Policisë Bashkiake**

<b>Nr</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>Paga</b>
1	Kryeinspektor i Policisë Bashkiake	80 000
2	Inspektor i Policisë Bashkiake	63 000
3	Policë të Policisë Bashkiake	47 000